



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3742/2 Prot.

Pogradec, më 18 .08 .2021

VENDIM

NR. 73 , DATË 17 .08 .2021

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TE MASAVE PER TE DALE NGA GJENDJA E
VESHTIRESIVE FINANCIARE”

Në mbështetje të, ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor te Republikës te Shqiperise", i ndryshuar, Ne mbeshtetje te nenit 102, pikes 4 , te Kushtetutes se Republikës se Shqiperise, te neneve 57 dhe 59 te ligjit nr 68 dt 17.04.2017” Per financat e vetqeverisjes vendore” dhe Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr 26 dt 27.09.2019 “Procedura per menaxhimin e veshtiresive financiare per njesite e vetqeverisjes vendore” dhe të Buxhetit Vjetor 2021 Bashkia Pogradec, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e masave per te dale nga gjendja e veshtiresive financiare
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar , të gjitha ndërmarjet në varësi të Bashkisë Pogradec .
- 3.Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EKONOMISE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2021

PLANI I MASAVE PER TE DALE NGA GJENDJA E VESHTIRESIVE FINANCIARE

Ne mbeshtetje te nenit 102, pikes 4 , te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, te neneve 57 dhe 59 te ligjit nr 68 dt 17.04.2017” Per financat e vetqeverisjes vendore” dhe Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr 26 dt 27.09.2019 “Procedura per menaxhimin e veshtiresive financiare per njesite e vetqeverisjes vendore”, me poshte po ju paraqesim Planin e masave per daljen nga gjendja e Veshtiresise Financiare.

Ne baze te analizes 6 mujore te dorezuar me pare prane jush rezulton qe jemi me nje deficit ndermjet fondeve ne dispozicion dhe shpenzimeve te planifikuara.

Sipas tabelave se meposhtme:

1.1 Tabela per fondet e disponueshme

Nr	Emertimi	Shuma per 6 mujoria 2-te
1	GRANT (shpenzime operative)	99,453,669
2	Te ardhurat	150,000,000
	TOTAL	249,453,669

Fondet ne dispozicion jane **249,453,669 lek**, duke patur parasysh qe te ardhurat jane **planifikim** per 6 mujorin e ardhshem.

Bashkia ka menduar qe me keto fonde ne dispozicion te beje nje plan shpenzimesh per muajt ne vazhdim. Per te reduktuar deficitin do nderhyjme ne shpenzimet baze te bashkise si psh: Ristrukturimi dhe berja e Organigrames se re te Bashkise, rishikimi i numrit te punonjesve dhe rishikimi i nivelit te pagave. Por gjithashtu eshte menduar dhe nje ndryshim tek Paketa Fiskale e Bashkise per te mbledhur borxhin e akumuluar nga debitoret por gjithashtu dhe rishikimi i disa pikave te Paketes Fiskale.



Duhet te theksojme se plani i masave te mesiperme efektet financiare do ti kete per nje periudhe te mevonshme dhe nuk do te mundemi qe te dalim nga kjo gjendje brenda muajit Gusht. Per kete gje Bashkia per muajt Gusht dhe Shtator 2021 do te pezulloje te gjitha veprimtarite financiare dhe do te shpenzoje vetem per nevojat bazike te ketij institucioni. Me poshte po ju paraqesim planin per dy muajt ne vazhdim. Ne muajin Gusht 2021 Bashkia do te paraqese ne Keshillin Bashkia dhe Organigramen e re dhe ndryshimet e munshme ne Paketën Fiskale. Me pas ne baze te te ardhurave te mbledhura te muajit, borxhit te viteve te meparshme dhe reduktimit te shpenzimeve do te paraqese nje plan tjetër per 3 mujorin e fundit te vitit 2021.

1. Bashkia Pogradec Qender

1.2 Tabela per planifikim e shpenzimeve per Gusht-Shtator 2021 per Bashkine Pogradec

Nr	Emertimi	Shuma
1	Paga dhe Sigurime shoq,shend	33,187,478
2	Energji	400,000
3	Uje	166,667
4	Internet, sherbim postar	680,000
5	KRWM	4,000,000
6	ASHK	40,000
7	Qera	522,800
8	Keshilltare, Kryepleqte	1,504,796
9	Pastrimi	18,000,000
10	Detyrime te prapambetura	6,000,000
	TOTAL	64,501,741

Keto jane shpenzimet bazike te Bashkise Qender per vazhdimesine normale te punes . Bashkia gjate ketyre dy muajve do te vazhdoje me prokurime me vlerë te vogel te cilat jane te domosdoshme per funksionimin e punes.

1.3 Tabela e kontratave te lidhura

NR	EMERTIMI I OBJEKTEVE	Vlera Totale sipas kontrates	Grant	Te ardhura
1	Rehabilitim I lagjes Gani Homcani	54,240,000	54,240,000	
2	Reabilitimi bllokut te banimit prane rruges "Abdyl Frasheri"	18,500,760	18,500,760	
3	Reabilitimii shesheve ne dy krahet e unazes (prane Sot7)	7,106,694	7,106,694	
4	Blerje makina	8,756,813	8,756,813	



5	Rrugicat (Perroi Caprazit + Kalaja)	3,169,020	3,169,020	
6	Perfundimi I punimeve rruga e Kabashit +20%	4,653,120	4,653,120	
7	Studime Projektme	19,740,000	8,328,000	11,412,000
8	Pajisje	1,916,640	1,916,640	
	SHUMA TOTALE PER INVESTIMET	118,083,047	106,671,047	11,412,000

Kontratat dhe likujdimet e faturave per investimet per te cilat jane lidhur kontratat do te vazhdojne te shlyhen sepse eshte nje detyrim ligjor. Gjithashtu duhet te theksojme se kontrata e lidhura ne vitin 2020 te cilat kane shtrirje likujdimi ne vitin 2021, do te vazhdojne te shlyhen duke qene se i kane fondet e bllokuara ne Degen e Thesarit.

Persa i perket prokurimit publik "Ndricim rrugor (Rikonstruksion)" i cili ka shtrirje likujdimi per tre vite me vlere 14,991,889 leke per 2021, 22,000,000 leke per 2022, 33,000,000 leke per 2023 ju informojme se kjo procedure nuk ndikon ne planin e shlyerjes se detyrimeve te prapambetura. Ky prokurim publik eshte bazuar ne fondet qe Bashkia harxhon per energjine elektrike mujore. Duke qene se energjia elektrike paguhet cdo muaj rregullisht per te mos patur kamatvonesa, kjo kontrate shihet me me shume efikasitet per institucionin. Ne baze te relacionit te grupit te punes energjia elektrike do te reduktohet dhe kjo con drejt uljes se kostove per energjine gjithashtu kontrata do te permbaje dhe mirembajtje 3 vjecare per rrjetin elektrik. Duke e permblodhur me pak fjale Bashkia do te reduktoje si faturat e nergjise elektrike ashtu dhe cdo shpenzim tjeter per mirembajten e ketij rrjeti.

2. NDERMARRJET E VARESISE

Persa i perket Ndermarrjeve te Varesise, Bashkia do te pezulloje cdo lloj Investimi per keto Ndermarrje ne 2 muajt ne vazhdim. Ndermarrjet do te kryejne shpenzimet e nevojshme per mbarevajtjen e punes. Bashkia Pogradec per muajt Gusht dhe Shtator vazhdon te jete ne sezon turistik dhe Ndermarrjet e varesise kane punen me te madhe per keto muaj. Qendra Kulturore "Lasgush Poradeci" do te zhvilloje aktivitet si Mokra ne Feste, Maratona e kenges, Festa e Koranit. Pavaresisht buxhetit te Bashkise per evenimente te ndryshme do te kerkojme dhe sponsorizime per te beret e mundur gjallerimin e qytetit. Gjithashtu Ndermarrja e Parqeve dhe Rekreacionit, Klubi Shumesportesh dhe Qendra Arsimore do te vazhdojne me shpenzimet bazike per mbarevajtjen e punes.

Ndermarrja e Mirembajtjes se Infrastruktures dhe Puneve Publike do te vazhdoje prokurimet publike si me poshte:

Në vazhdimësi të korrespondencës së mbajtur, në lidhje me zbatimin e Vendimit Nr. 139, datë 22.07.2021, "Për fillimin e procedurës për shpalljen e gjëndjes së vështirësisë financiare", i



protokolluar pranë N.M.I.P.P me Nr. 750 Prot, datë 04.08.2021, në të cilën pika nr.2, përcakton "pezullimin përkohësisht vazhdimin e procedurave të prokurimit publik në proces, për të cilat nuk është nënshkruar kontrata për vlera mbi 1 000 000 lekë", po Ju informojmë si më poshtë vijon:

Nga ana e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor është zhvillur procedura e prokurimit me objekt "Karburant", **Lloji i procedurës se prokurimit:** "E Hapur" - "Mallra" - "Marrëveshje Kuadër - Nje operator ekonomik, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara", dhe **Fondi limit i marrëveshjes kuadër: 14 623 082** (Katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e njetete e tre mije e tetëdhjete e dy) lekë, vënë në dispozicion nga "**Të ardhurat e bashkisë per vitin 2021**" dhe "**Buxheti i shtetit**" i miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 144, datë 24.12.2020, "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të bashkise Pogradec për vitin 2021". Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.06.2021.

Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër, për: Operatorin ekonomik pjesëmarrës, GORA 2004 SHPK, me adresë sipas ekstraktit të QKB-se "Bucimas, Ruga e Volorekës, Pogradec", me numer NIPT: K44802603B, është publikuar më datë 05.07.2021.

Marreveshja Kuader është lidhur më datë 16.07.2021, Nr.265/4 Prot.

Ne zbatim të dispozitave ligjore, si dhe referuar Dokumentave Standarte të Tenderit, A.K rezervon të drejtat si më poshtë:

- *Sasite e parashikuara dhe kerkuara jane vetem sasi orientuese dhe NUK e kushtezojne AK per t'i blere ato.*
- *Ak ka te drejte te bleje me pak apo me shume sasi sesa te parashikuara, (por ne cdo rast brenda vleres se perlogaritur te marreveshjes kuader).*

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana Juaj, autorizimin për nënshkrimin e kontratave sipas nevojave që ka N.M.I.P.P.

Gjithashtu, nga ana e Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, u zhvillua procedura e prokurimit me objekt "Mirëmbajtje ndertesash", me datë të hapjes së ofertave **27.07.2021, ora 09:00**, me fond limit **14 200 299,8** (Katërmëdhjetë milion e dyqind mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë presje tetë) lekë.

Në zbatim të Vendimit të sipërcituar, i shfuqizuar pjesërisht, nga ana jone mund te kryejme veprim procedural deri ne shpalljen e fituesit, por nenshrkimi i kontrates do te realizohet pas autorizimit nga ana e Keshillit te Bashkise Pogradec.

Mos nënshkrimi i kontrates, do te sillte probleme ne garantimin e kushteve të procesit mësimor, kushteve të higjenës në shkolla dhe garantimin e zhvillimit të procesit mësimor.



Për sa më sipër, kërkojmë nga ana Juaj, marrjen e masave për nënshkrimin e kontratës me objekt "Mirëmbajtje ndertesash".

Bazuar ne nevojat qe do te lindin, per garantimin e fillimit te procesir mesimor, me datë 01.09.2021, duhet te garantoni fondet, ne menyre qe te filloje procedurat e prokurimit per objektet si me poshtë:

1. Materiale hidraulike, fondi limit pa TVSH, 583 333 (Peseqind e tetedhete e tre mije e treqind e tridhete e tre) lekë.
2. Blerje materiale Covid 19, fondi limit pa TVSH, 625 000 (Gjashteqind e njezete e pese mije) Leke.
3. Blerje materiale pastrimi, fondi limit pa TVSH, 141 666 (Njeqind e dyzete e nje mije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte) lekë.
4. Materiale hidraulike, fondi limit pa TVSH, 583 333 (Peseqind e tetedhete e tre mije e treqind e tridhete e tre) lekë.
5. Materiale elektrike, fondi limit pa TVSH, 575 000 (Peseqind e shtatedhete e pese mijë) lekë.

Pergjate ketyre 2 muajve Bashkia do te kryeje shpenzimet e nevojshme dhe do te studioje gjendjen e saj. Pezullimi i veprimtarive ekonomike eshte nje domosdoshmeri. Me lart kemi listuar te gjitha shpenzimet qe do te kryeje Bashkia por dhe ato qe jane ne proces qe jane te domosdoshme per funksionimin e puneve. Kerkojme nga ana juaj miratimin e planit te mesiperm dhe presim rekomandime per funksionimin e muajve ne vazhdim.

DREJTORIA E EKONOMISE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

IRSA KARAPANÇA



**KRYETAR
Ilir XHAKOLLI**

